



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1328 Prot.

Tiranë, më datë 18.11.2022

VENDIM  
Nr. 514, datë 18.11.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.11.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Potencialit Arkeologjik, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji Z.Ylli Cerova, në kuadër të projektit “Rikonstrukcion Objekti ekzistues 2 kate mbi tokë dhe shtesë anësore”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "B", Durrës me aplikues Adlei Likmeta dhe zhvillues “Desla” sh.p.k;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë procedrën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planfikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punime të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, nga DRTK Tiranë;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Eugen KALLFANI

